



Ministria e Shëndetësisë
Ministrastvo Zdrastvo
Ministry of Health



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL
AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU
CIVIL REGISTRATION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME MINISTARSTVO UNUTRANJE POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS
AGJENCIA E REGJISTRIMIT CIVIL AGENCIJA ZA CIVILNU REGISTRACIJU
CIVIL REGISTRATION AGENCY

Nr./Br./No. 03
Pr. No. 5364
Data/Datum/Date 03.10.2019
PRISHTINË - PRISTINA

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
ZYRA E KRYEMINISTRIT-URED PREMIERA-OFFICE OF PRIME MINISTER
AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS-AGENCIJA ZA STATISTIKI KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Nr./Br./No. 04-052-3288
Nr. i fq./Br. str./No. pg. 1/6
Data/Datumi/Date: 03.10.2019
PRISHTINË/PRISTINA/PRISTINA

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njësia Org. Nr. Prot.
Org. Jedinica Broj Prot.
Org Unit 02 Prot. No. 05-5360

Nr. i faqeve Datum:
Br. stranica - 6 - Date: 04.10.2019
No. pages Prishtinë / a

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

ndërmjet:

Ministresë së Shëndetësisë,
Agjencisë së Statistikave të Kosovës
Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe

Për:

Raportimin e indikatorëve shëndetësor

Prishtinë,
03.10.2019

Palët në rastin e nënshkrimit përfaqësohen nga:

1. Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës (MSH) e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Dr. Naim Bardiqi, adresa: Rr. Zagrebit nr. 60 Prishtinë,
2. Agjencia e Statistikave e Republikës së Kosovës (ASK), e përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Isa Krasniqi: adresa Rr. Zenel Salihu 10 000 Prishtinë;
3. Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Bekim Hoxha, adresa: Rr. Luan Haradinaj 10000 Prishtinë, dhe

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është harmonizimi i aktiviteteve dhe nën aktiviteteve për gjenerimin e raporteve për sektorin e shëndetësisë konform rregullave dhe procedurave sipas indikatorëve shëndetësor për nevojat e institucioneve të Republikës së Kosovës, për EUROSTAT, UNECE, OECD dhe institucionet tjera rrespektive për nxjerrjen e indikatorëve për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 (SDG-ve) edhe institucionet tjera.

Neni 2 Obligimet e Ministrisë së shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë përmes Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) si qendër referente e Ministrisë së Shëndetësisë për analizën e të dhënave, përgatitjen e raporteve dhe indikatorëve relevant shëndetësor do të ofron të dhëna për indikatorët shëndetësor që shërbejnë si burim i të dhënave për ASK –në në hartimin e raporteve të ndryshme dhe dërgimin e të dhënave tek institucionet tjera kombëtare e ndërkombëtare;

Neni 3 Obligimet e ASK-së

Agjencia e Statistikave të Kosovës publikon raporte të rregullta për indikatorët shëndetësor dhe raporton në EUROSTAT për indikatorët bazë shëndetësor (The European Core Health Indicators (ECHI), UNECE, OECD si dhe organizatat tjera bazuar në mekanizmat e përcaktuar për të dhënat e disagreguara sipas gjinisë, moshës, gjendjes-socio-ekonomike dhe sipas shtrirjes gjeografike.

Neni 4

Obligimet e Agjencisë se Regjistrimit Civil

Agjencia e Regjistrimit Civil do të ofron të dhëna elementare të qytetarëve të Republikës së Kosovës si dhe të dhëna lidhur me lindjet, vdekjet dhe të dhëna tjera përcjellëse që shërbejnë si burim i të dhënave për ASK-në në hartimin e raporteve të ndryshme.

Neni 5

Obligimet e përbashkëta

1. Ministria e Shëndetësisë, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës krijojnë mekanizmin e përbashkët për monitorimin e zbatimit të Memorandumit të Bashkëpunimit të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë¹, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës dhe Agjencia e Regjistrimit Civil.
2. Mekanizmi i përbashkët (Grupi punues) përbëhet prej 7 anëtarëve. Anëtarët (nga 2 anëtarë nga ASK, IKSHPK, ARC dhe një nga MSH) emërohen në koordinim mes Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, Drejtorit Ekzekutiv të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikës dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit Civil.
3. Brenda 3 muajsh pas Marrëveshjes së Mirëkuptimit mekanizmi i përbashkët (grupi punues për indikatorët shëndetësor) përpilon listën me indikatorët bazik të nevojshëm për institucionet vendore dhe ndërkombëtare si dhe formën e raportimit/qasjes.
4. Grupi punues mban takime të rregullta sipas nevojës dhe harton raportin vjetor për zbatimin e memorandumit të bashkëpunimit;
5. Institucionet obligohen të hartojnë Procedurë standarde të operimit (PSO) për shkëmbimin e të dhënave.

Neni 6

Furnizimi me të dhëna

1. Ofrimi i të dhënave për ASK-në/Departamentet përkatëse të Agjencisë së Statistikave të Kosovës është i mbështetur në Ligjin Nr. 04/L-036 “PËR STATISTIKAT ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS”
2. Furnizimi i të dhënave bëhet sipas pikave përkatëse të Nenit 2 dhe Nenit 3 të kësaj Marrëveshje.
3. Transmetimi i të dhënave të bëhet në mënyrë elektronike (system to system) në përjashtim të atyre që nuk janë të disponueshme në formë elektronike.
4. MSH-së në bashkëpunim me Agjencinë e Regjistrimit Civil duhet të ndërmarrin masa konform Ligjit Nr. 04/L-003 nenit 50 pika 4 për gjendjen civile.

¹ Institucionet e ndryshme të Ministrisë së Shëndetësisë

5. Të dhënat do të dërgohen në formë të pjesërishtme apo të plotë sipas kërkesave në pikat përkatëse të Nenit 2 dhe Nenit 4 të kësaj marrëveshje.
6. Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë harmonizimin e të dhënave, përshtat nomenklaturën adekuate, kontrollon kualitetin e të dhënave/mbulueshmërinë, gjithë përfshirjen dhe jep komente sipas nevojës.
7. Ministria e Shëndetësisë (MSH) përmes Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës do t'i ofrojë Agjencisë të Statistikave të Kosovës (ASK-së), përkatësisht *Departamentit të Statistikave Sociale (DSS)*, të dhënat e mëposhtme:
 - 7.1. Të dhënat për Treguesit Evropian të shëndetit Bazë (TESHB) "The European Core Health Indicators (ECHI)";
 - 7.2. Të dhënat për lindje, vdekje dhe shkaqet e vdekjeve (forme elektronike/ system to system) sipas kërkesës së ASK që kërkohen të dërgohen tek institucionet ndërkombëtare Eurostat (European Unified Demographic data & Demographic Ballance and Rates), UNECE dhe OECD.
8. Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) do t'i ofrojë Agjencisë të Statistikave të Kosovës (ASK-së), përkatësisht *Departamentit të Statistikave Sociale (DSS)*, të dhënat e mëposhtme:
 - 8.1. Të dhënat bazë nga Regjistri i gjendjes civile;
 - 8.2. Të dhënat për lindje, vdekje, kurorëzime dhe të dhëna tjera përcjellëse që ndërlidhen me lindje dhe vdekje.

Neni 7

Përdorimi i të dhënave

1. Të dhënat e ofruara nga Ministria e Shëndetësisë/ Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia e Statistikave të Kosovës do t'i shfrytëzojnë ekskluzivisht për qëllime statistikore, respektivisht për përpilimin e raporteve dhe dërgimin e të dhënave tek institucionet tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Të dhënat shfrytëzohen edhe për azhurnimin e Regjistrimit të popullsisë duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare mbi ruajtjen e të dhënave konfidenciale.
3. Të dhënat e ofruara do të përpunohen, analizohen dhe publikohen në formë elektronike në Ueb faqe të ASK-së, dhe nëse është nevojë edhe në forme të shtypur. Të dhënat do të bëhen publike për të gjitha institucionet qeveritare dhe joqeveritare (duke ruajtur të dhënat konfidenciale në pajtim me MSH dhe ARC).
4. ASK do ta informojë MSH dhe ARC lidhur me planin e publikimit të të dhënave.
5. ASK do të citojë burimin e të dhënave.
6. IKSHPK do të caktojë një /disa persona të cilët janë përgjegjës që në bashkëpunim me ASK ti publikojnë indikatorët shëndetësor si dhe të bashkëpunojnë që të dhënat të dërgohen tek institucionet ndërkombëtare Eurostat (European Unified Demographic data & Demographic Ballance and Rates), UNECE, OECD si dhe organizata tjera ndërkombëtare.
7. ASK-ja do të caktojë një/disa persona (me një vendim të veçantë) të cilët janë përgjegjës për grumbullimin, sistematizimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave. Në rast të shkeljes së konfidencialitetit, personat e caktuar për ruajtjen e të dhënave do të përgjigjen sipas ligjit në fuqi mbi ruajtjen e të dhënave personale.

8. Publikimi shkaqet e vdekjes në Kosovë është punë e përbashkët e IKSHPK (e cila bënë kodifikimin e shkaqeve të vdekjes) derisa ASK-ja përgatitë raportin.
9. Në data bazën e vdekjeve mund të kenë qasje dy institucionet (ASK dhe IKSHPK) sipas standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi të Kosovës.
10. Palët pajtohen që do të ketë bashkëpunim edhe në ofrimin-këmbimin e njohurive në mes të këtyre institucioneve si dhe pjesëmarrje të përbashkët aty ku ka mundësi si: në trajnime, punëtori, seminare dhe fusha të tjera të bashkëpunimit (përpilimin e metodologjisë, raporteve, publikimeve, konferencave) etj.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat që shkëmbehen në mes të MSH, ARC dhe ASK nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar dhe/ose përpunuar. Përpunimi dhe përdorimi i të dhënave personale nga ky memorandum duhet të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 9

Kushtet tjera

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet, plotësohet apo anulohet me marrëveshje të përbashkët të palëve, gjashtëdhjetë (60) ditë nga shkresa e dërguar palës tjetër.
2. Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për t'i zgjedhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet dhe pretendimet që lindin nga ose në lidhje me Marrëveshjen.
3. Të gjitha ndryshimet apo shtesat e kësaj Marrëveshje do të bëhen efektive vetëm pas pajtimit të të tri palëve në një dokument të shkruar.
4. Kjo Marrëveshje do të jetë e zbatueshme që nga data e nënshkrimit nga të trija palët.
5. Kjo Marrëveshje shfuqizon marrëveshjet e mëparshme të të njëjtës natyrë në mes të tri institucioneve.

Neni 10

Zgjidhja e Mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet të zgjidhen me mirëkuptim.

Neni 11
Hyrja në Fuqi

1. Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.
2. Marrëveshja e Mirëkuptimit është nënshkruar në gjashtë kopje, nga dy kopje për secilën palë nënshkruese.
3. Kjo marrëveshje është përgatitur në tri kopje të njëjta, në gjuhën shqipe dhe i është dhënë secilës palë në këtë marrëveshje.
4. Në prani, palët e poshtëshënuara, bëjnë nënshkrimin e kësaj Marrëveshje .

Sekretari i Përgjithshëm i MSH

Dr. Naim Bardiqi



Kryeshefi ekzekutiv i ASK

Z. Isa Krasniqi



Drejtori i Përgjithshëm i ARC

Z. Bekim Hoxha



Datë:03/10/2019